



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

RAPORT STUDIMOR

MBI VLERËSIMIN DHE ANALIZËN E GJENDJES SË KATËR LIQENEVE DHE SISTEMIN E VADITJES NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MAQËLLARË.

Ky raport u realizua nga eksperti Elmaz Kadria, në kuadër të projektit “Liqenet Funksionale ndihmë për Maqellarën”, me mbështetjen financiare të Leviz Albania, një projekt i Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.



PERMBAJTJA:

Hyrje	3
1. Përmbledhja e studimit	4
2. Liqenet e marra në studim	4
2.1 Liqeni i fshatit Fushë e Vogël (Kurbeg)	4
Fig.1 Hartë topografike e Liqenit të fshatit Fushë e Vogël.....	4
Fig.2 Plan Rilevimi i Liqenit të fshatit Fushë e Vogël	5
Fig. 3 Hartë treguese mbi matjet e Liqenit të fshatit Fushë e Vogël	6
Fig.4 Profilet tërthore sipas seksioneve për Liqenin e fshatit Fushë e Vogël	7
Fig.5 Profilet tërthore sipas seksioneve për Liqenin e fshatit Fushë e Vogël	8
Tabela.1 Përlllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin Fushë e Vogël	9
2.2. Liqeni i fshatit Çermenë (Vojnikë)	9
Fig.6. Hartë topografike e liqenit të fshatit Çermenë	10
Fig.7. Plan Rilevimi i liqenit të fshatit Çermenë	11
Fig. 8. Hartë treguese mbi matjet e liqenit të fshatit Çermenë	12
Fig.9 Profilet tërthore sipas seksioneve për liqenin e fshatit Çermenë	13
Tabela.2. Përlllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin Çermenë	14
2.3. Liqeni i fshatit Maqellars (Pesjakë)	14
Fig.10. Hartë topografike e fshatit të liqenit të fshatit Maqellarë	14
Fig.11. Plan Rilevimi i fshatit të liqenit të fshatit Maqellarë	15
Fig.12. Hartë treguese mbi matjet e fshatit të liqenit të fshatit Maqellarë	16
Fig.13 Profilet tërthore sipas seksioneve për liqenin e fshatit Maqellarë	17
Tabela.3. Përlllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin Maqellarë	18
2.4. Liqeni i fshatit Grazhdan	18
Fig.14. Hartë topografike e liqenit të fshatit Grazhdan	18
Fig.15. Plan Rilevimi i liqenit të fshatit Grazhdan	19
Fig. 16. Hartë treguese mbi matjet e liqenit të fshatit Grazhdan	20
Fig.17 Profilet tërthore sipas seksioneve për liqenin e fshatit Grazhdan	21
Tabela.4. Përlllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin Grazhdan	22
3. Mbushjet me aluvione	22
Tabela 5 Të dhënat lidhur me depozitimet të shprehura në m ³ të ujëmbledhësve në vite	22



Financuar nga LevizAlbania



Në projekt i Agjencisë Zvicarane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicarane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

të ndryshme	23
4. Konkluzione	23
4.1 Problematikat kryesore të konstatuara	23
4.2 Shkaktarët kryesorë të kësaj situatë	23
5. Rekomandime	24
Tabela.6. Të dhënat teknike lidhur me kapacitetin e ujëmbledhësve dhe përmasimi i tyre	24

Qëllimi i projekt-studimit :

- Qëllimi i këtij studimi është matja topografike e liqeneve dhe pellgjeve ujëmbledhëse.
- Verëfikimi i pasurive nga planet e rievimit dhe i hartave treguese.
- Nxjerrja e volumeve faktike të ujëmbledhësve, krahasimi i tyre me vitet e mëparshme dhe identifikimi i depozitimeve që janë kryer ndër vite shprehur në m³.
- Ilogaritja e kostos për gërmimet, pastrimet dhe vënien në funksion të plotë të sistemit të vaditjes për secilin ujëmbledhës .

Grupet e synuara:

Komunitetet lokale dhe fermerët e gjashë fshatrave të Njësisë Administrative Maqellarë. Fshatrat, banorët e të cilëve interesohen drejtpërdrejtë për kthimin në funksion të këtyre Ujëmbledhësve janë: Maqellarë, Çernenë, Fushë e Vogël, Vojnikë, Kovashicë dhe Grazhdan, por edhe fshatra të tjerë kanë përfitimet e tyre.

Outputet:


- Raport i hartuar mbi përfundimet kryesore
- Hartat dhe imazhet satelitore



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicarase për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicarase për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

1. HYRJE

Njësia Administrative Maqellarë është e shtrire gjeografikisht rrëzë vargmalit të Deshatit i cili është shumë i pasur me burime ujore, menaxhimi i të cilëve është i lidhur ngushtësisht me mirfunksionimin e liqeneve që ata furnizojnë.

Për realizimin e qëllimit të këtij studimi u punua në tri drejtime: Informim, matje në terren dhe punë me hartat dixhitale.

- Informimi u fokusua në pika të tilla si: vitet e ndërtimit, kapacitetet fillestare, ndërhyrjet që janë kryer, burimet e furnizimit, kapacitetet vaditëse të liqeneve.
- Matjet u kryen në terren me instrument topografik, duke përcaktuar gjatësinë dhe lartësinë e digave, si dhe duke evidentuar gjendjen teknike të ujëlëshuesve, shkarkuesve të sigurisë dhe situatës faktike dhe funksionimit teknik në përgjithësi.

Për nxjerrjen e kapacitetit mbushës dhe përmasimit u punua me hartat dixhitale të sistemit GIS &TIFF sipas linkut të mëposhtëm dhe të azhornuara me të dhënat e matjeve në terren e të pasqyruara me tabelat përkatëse në këtë studim.

<https://drive.google.com/drive/folders/1dSzJd25qh1SkfFY1uQ2vpncu4dJQAvyI>

Më poshtë gjeni materialin e zgjeruar studimor për secilin nga liqenet dhe specifikimet sipas rastit.

II. Liqenet e marra në studim

2.1 Liqeni i fshatit Fushë e Vogël i ndërtuar në vitin 1969 me digë (gjatësi 70m, lartësi 8m) me kapacitet rreth 35,000 m³ ujë për vaditjen e 10 hektarëve tokë bujqësore. Ndërhyrja e vetme e bërë në këtë liqen është ajo vitit 2019, vetëm në spostimin e një sasive të materialit mbushës. Per kete liqen te marre ne studim pas matjeve te kryera ne terren jane nxjerre : harte topografike, plan rlevimi, hartë treguese mbi matjet, profilet tërthore të tij sipas seksioneve mbi bazë të të cilave është hartuar tabela me volumet e mbushjes.


Fig.1. Hartë topografike Liqeni Fushë e Vogël






Fig.2 Plan Rilevimi për liqenin e fshatit Fushë e Vogël

PLAN RILEVIMI

PËRGATITI	IDENTIFIKIMI I PASURISE
SHOQËRIA: "SELAMI sh.p.k"	ZONA KADASTRALE: <u>1662</u>
TOPOGRAFI: Elmaz KADRIA	NR. I PASURISE: <u>63</u> VL. <u>PO.</u>
LIÇENCË Nr. - NZ.1859/15	INDEKSI I HARTES: <u>K-34-87-(63-B)</u>
Data: 23.03.2018	SHKALLA: <u>1:2500 "FUSHA-VOGËL"</u>
Data e Përgatitjes: <u>06/03/2020</u>	ADRESA E PASURISE: <u>RRETHI, DIBER</u>
	PRONARI / ET: <u>SHTETI</u>
	PASURIA NR. <u>63</u>
	SIPERFAQJA (m ²): <u>4350 m²</u>
	PRONARI: <u>SHTETI</u>
	<u>REZERVUARI: "FUSHA-VOGËL"</u>



KUFIZIMET

VERU - NR. I PASURISE:	<u>61</u>
LINDJA - NR. I PASURISE:	<u>62</u>
JUGU - NR. I PASURISE:	<u>65/1</u>
PERENDIMI - NR. I PASURISE:	<u>ZON - URBANE</u>

Fig.3 Hartë treguese mbi matjet për liqenin e fshatit Fushë e Vogël



Fig.4 Profilët tërthore sipas seksioneve për liqenin e fshatit Fushë e Vogël




Fig.5 Profilët tërthore sipas seksioneve për liqenin e fshatit Fushë e Vogël






Tabela.1 Përlllogaritja e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin e fshatit Fushë e Vogël

Seksioni	Sipërfaqja (m2)	Sipërfaqja mesatare (m2)	Distanca mes Seksioneve (m)	Volumi (m3)
A	2.7			
B	13.2	7.95	20	159
C	21.1	17.15	20	343
D	21.6	21.35	20	427
E	25.2	23.4	20	468
F	22.6	23.9	20	478
G	21.4	22	20	440
H	21.9	21.65	20	433
I	21.9	21.9	20	438
J	18.7	20.3	20	406
K	18.6	18.65	20	373
Totali				3,965

Rekomandim: pozicioni në të cilin ndodhet liqeni ka hapësirë për zgjerimin dhe rritjen e kapacitetit ujëmbledhës të tij, përforcimin e digës ekzistuese, dhe përmirësim në menaxhimin e furnizimit gjatë periudhës dimër -pranverë.

2.2 Liqeni i fshatit Çernenë i ndërtuar në vitin 1966 me digë (gjatësi 60 m, lartësi 15m) me kapacitet rreth 45,000 m³ ujë për vaditjen e 15 ha tokë bujqësore. Ndërhyrja e vetme e bërë në këtë liqen është ajo vitit 2018 duke zhbllokuar ujëlëshuesin i cili është sërish jashtë funksionit dhe rrjedhimisht edhe vete liqeni nuk është në funksion. Per këtë liqen të marrë në studim pas matjeve të kryera në terren janë nxjerrë: hartë topografike, plan rievimi, hartë treguese mbi matjet, profilet tërthore të tij sipas seksioneve mbi bazë të të cilave është hartuar tabela me volumet e mbushjes.



Fig.7 Plan Rilevimi per liqenin Cernene

PLAN RILEVIMI

PËRGATITI SHOQËRIA: "SELAMI sh.p.k" TOPOGRAFI: Elmaz KADRIA LIÇENCË Nr. - NZ.2859/15 Datë: 23.03.2018 Data e Përgatitjes: <u>06/03/2020</u> <i>(E-KADRIA)</i> <i>[Signature]</i>	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE: <u>1384</u> NR. I PASURISE: <u>170/1; 170/vl.</u> FO. INDEKSI I HARTES: <u>X-34-89.(63-0)(79-B)</u> SHKALLA: <u>1:2500 " CERNENI.</u> ADRESA E PASURISE: <u>RRETHI, DIBER</u> PRONARI / ET: <u>SHTETI</u> PASURIA NR. <u>170/1 ; 170/vl</u> SIPERFAQJA (m2): _____ PRONARI: <u>SHTETI</u>
--	--

REZERVUARI = CERNENI II

1384

176
CERNEN
SH.1

KUFIZIMET	
VERIU - NR. I PASURISE:	<u>170/3</u>
LINDJA - NR. I PASURISE:	<u>176</u>
JUGU - NR. I PASURISE:	<u>255</u>
PËRENDIMI - NR. I PASURISE:	<u>67/1</u>

Fig.8 Hartë treguese mbi matjet për liqenin e fshatit Çernenë




Fig.9 Profilet tërthore sipas seksioneve për liqenin Çermenë






Tabela 2 Përlllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin e fshatit Çermenë

Seksioni	Siperfaqja(m ²)	Siperfaqja mesatare (m ²)	Distanca mes seksioneve (m)	Volumi (m ³)
A	42			
B	85.3	63.65	20	1.273
C	96.5	90.9	20	1.818
D	129.5	113	20	2.260
E	98.8	114.15	20	2.283
F	72.5	85.65	20	1.713
G	70.5	71.5	20	1.430
H	7.7	39.1	20	78.2
Totali				11.559

Rekomandime: riparimi ose vendosja e një ujëlëshuesi të ri, pastrimi nga mbushjet, ndërprerja e shkarkimit të ujrave të zeza në këtë liqen, mundësimi i furnizimit të këtij liqeni nga burimet e vargmalit Deshat nëpërmjet kanaleve përgjatë rrugës nacionale Maqellarë – Tiranë.

2.3 Liqeni i Maqellarës i ndërtuar në vitin 1969 me digë (gjatesi 80m, lartesi 10m) me kapacitet rreth 51,000 m³ ujë për vaditjen e 17 hektarëve tokë bujqësore. Për këtë liqen të marrë në studim pas matjeve të kryera në terren janë nxjerrë: hartë topografikë, plan rievimi, hartë treguese mbi matjet, profilet tërthore të tij sipas seksioneve mbi bazë të të cilave është hartuar tabela me volumet e mbushjes.



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicërore për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin SDG



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicërore për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDG


Fig.10 Hartë topografike e liqenit të fshatit Çernenë






Fig.11 Plan Rilevimi për liqenin të fshatit Maqellarë

PLAN RILEVIMI

PËRGATITI SHOQËRIA: "SELAMI sh.p.k" TOPOGRAFI: Elmaz KADRIA LIÇENCË Nr. - NZ.2859/15 Datë: 23.03.2018 Data e Përgatitjes: 06/03/2020  <i>E-KADRIA</i>	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE: <u>2592</u> NR. I PASURISE: <u>88/33</u> VL. 3 FQ. 92 INDEKSI I HARTES: <u>K-34-89-(64-0)</u> SHKALLA: <u>1:2500⁰ MAQELLARE.</u> ADRESA E PASURISE: RRETHI, DIBER PRONARI / ET: <u>SHTETI</u> PASURIA NR. <u>88/33</u> SIPERFAQJA (m ²): <u>5735 m²</u> PRONARI: <u>SHTETI</u>
---	---

REZERVUARI⁰ - "MAQELLARE"₄



KUFIZIMET	
VERIU - NR. I PASURISE:	<u>88/85</u>
LINDJA - NR. I PASURISE:	<u>Fidoh. Pasjort</u>
JUGU - NR. I PASURISE:	<u>88/40</u>
PERENDIMI - NR. I PASURISE:	<u>88/40</u>

Fig.12 Hartë treguese mbi matjet për liqenin Maqëllarë



Fig.13 Profilët tërthore sipas seksioneve për liqenin Maqëllarë






Tabela.3 Përlllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin e fshatit Maqëllarë

Seksioni	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja mesatare (m2)	Distanca mes Seksioneve (m)	Volumi (m3)
A	38.6			
B	66.6	52.65	20	1,052
C	51	58.8	20	1,176
D	39	45	20	900
E	7.5	23.25	20	465
Totali				3,593

Rekomandime: pozicioni në të cilin ndodhet liqeni ka hapësirë për zgjerimin dhe rritjen e kapacitetit ujëmbajtës të tij dhe përforcimin e digës ekzistuese. Pozita gjeografike që ka ky liqen, i pozicionuar pranë vargmalit të Deshatit favorizon furnizimin e tij me prurjet e përroit, ujëvarës së Pocestit dhe burimeve të tjera të këtij mali.

2.4 Liqeni i Grazhdanit i ndërtuar në vitin 1972 me digë (gjatësi 200m, lartësi 22m) me kapacitet rreth 400,000 m³ ujë për vaditje e 80 ha tokë bujqësore. Për këtë liqen të marrë në studim pas matjeve të kryera në terren janë nxjerrë: hartë topografike, plan rievimi, hartë treguese mbi matjet, profilet tërthore të tij sipas seksioneve mbi bazë të të cilave është hartuar tabela me volumet e mbushjes.



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Fig.14 Hartë topografike e liqenit të fshatit Grazhdan








Fig.15 Plan Rilevimi për liqenin e fshatit Grazhdan

PLAN RILEVIMI

PËRGATITI	IDENTIFIKIMI I PASURISE
SHOQËRIA: "SELAMI sh.p.k"	ZONA KADASTRALE: <u>1850</u>
TOPOGRAFI: Elmaz KADRIA	NR. I PASURISE: <u>876</u> VL. <u>3</u> FO. <u>179</u>
LIÇENCË Nr. - NZ.2859/15	INDEKSI I HARTES: <u>K.34.89(48.A)(48.C)</u>
Datë: 23.03.2018	SHKALLA: <u>1:2500 "GREZH DAN,</u>
Data e Përgatitjes: <u>06/03/2020</u>	ADRESA E PASURISE: <u>RRETHI, DIBER</u>
 <u>E-KADRIA</u>	PRONARI / ET: <u>SHJETI</u>
	PASURIA NR. <u>876</u>
	SIPERFAQJA (m ²): <u>29.573 m²</u>
	PRONARI: <u>SHJETI</u>
	REZERVUARI: "GREZH DAN,



KUFIZIMET

VERIU - NR.I PASURISE:	<u>859/13</u>
LINDIA - NR. I PASURISE:	<u>867/1</u>
JUGU - NR. I PASURISE:	<u>875/2</u>
PERENDIMI - NR. I PASURISE:	<u>875/2 : 859/13</u>

Fig.16 Hartë treguese mbi matjet për liqenine fshatit Grazhdan



Fig.17 Profilet tërthore sipas seksioneve për liqenin Grazhdan






Tabela.4 Përllogaritje e volumit të mbushjes me aluvione për liqenin Grazhdan

Seksioni	Siperfaqja (m2)	Siperfaqja mesatare (m2)	Distanca mes Seksioneve (m)	Volumi (m3)
A	36.6			
B	86.6	61.6	20	1,232
C	185.7	136.15	20	2,723
D	269	227.35	20	4,547
E	264	266.5	20	5,330
F	300.8	282.4	20	5,648
G	316.7	308.75	20	6,175
H	250	283.35	20	5,667
I	74.2	162.1	20	3,242
Totali				34,564

Rekomandime: pastrimi i mbushjes nga aluvionet të grumbulluara në sasi të konsiderueshme si pasojë e vendodhjes së këtij liqeni pranë vargmalit të Deshatit, sistemimi i kanaleve furnizuese dhe rishikimi i mundësisë për ngritjen e lartësisë së digës duke rritur kapacitetin ujëmbajtës të tij.

3. Mbushjet me Aluvione

Për sa i përket gjengjes egzistuese të depozitimeve, janë kryer edhe matjet topografike në terren nëpërmjet të cilave janë nxjerrë kuotat referencë në pika të caktuara për të bërë krahasimin me rezultatet që do të gjenerohen nëpërmjet softëare-it.

Vlerësimi i depozitimeve nëpërmjet këtyre imazheve është bërë i mundur nëpërmjet softëare-it GIS (Geographical Information System). Në mungesë të të dhënave fizike dhe dixhitale për periudhën para vitit 2015, për të bërë vlerësimin e gjendjes së depozitimeve për periudhat e mëparshme është përdorur metoda e interpolimit linear.

Tabela 5: Të dhënat lidhur me depozitimet të shprehura në m³ të ujëmbledhësve në vite të ndryshme

Emri i Liqenit	Volumi i depozitimeve ne vitin 2015 (m ³)	Volumi i depozitimeve ne vitin 2020 (interpolim linear)	Kosto per pastrimin
Liqeni i Grazhdanit	34,564	38,583	27,779,810
Liqeni i Vojnikës (Çernenës)	11,559	12,815	9,226,800
Liqeni i Pesjakës	3,593	3,960	2,851,200



(Maqellares)			
Liqeni i Kurbegut (Fushes se Vogel)	3,965	4,527	3,259,440

Për të bërë të mundur vlerësimin nga pikëpamja teknike e depozitimeve të krijuara ndër vite në liqenet e mësipërme, janë shfrytëzuar të dhënat e siguruar nga ana e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit sa u përket të dhënave lidhur me imazhet TIFF (Taged Image File Format) që i përkain vitit 2015.

Bashkëngjitur Link-u i të dhënave Teknike

<https://drive.google.com/drive/folders/1dSzJd25qh1SkfFY1uQ2vpncu4dJQAvyI>

Për sa më sipër, duke analizuar situatën në terren të këtyre ujëmbledhësve konstatohet se depozitimet e akumuluar ndër vite kanë bërë të mundur zvogëlimin e kapacitetit mbajtës së tyre dhe për pasojë dhe reduktimin e vaditjes së sipërfaqeve të mbjella.

4. KONKLUZIONE

4.1 Problematikat kryesore të konstatuara:

- Zvogëlimi i kapacitetit mbajtës të ujëmbledhësve;
- Gjendja teknike jo e mirë e digave;
- Mungesa e furnizimit për mbushjen e tyre;
- Amortizimi teknik i ujëlëshuesve.

4.2 Shkaktarët kryesorë të kësaj situatë janë:

- Mbushja e liqene me aluvione për shkak të erozionit dhe shkatërrimit të mjedisit ndër vite.
- Linjat e furnizimit me ujë (kanalet ushqyese) janë të dëmtuara ose tërësisht jashtë funksionit.
- Mungesa e mirëmbajtjes së digave, përfshirë këtu shkarkuesit katastrofikë, ujëlëshuesit, ndërtimin e pritave për mbrojtjen nga erozioni si dhe pastrimin e liqeneve nga aluvionet.
- Konfliktet e pronësisë për truallin ku janë ndërtuar këto ujëmbledhës.
- Mungesa e bashkëpunimit midis grupeve të interesit për të përmirësuar sistemin e vaditjes.

Nga verifikimet, matjet topografike, informacioni i grumbulluar nga takimet me ish punonjës të kooperativave bujqesore që kanë punuar në sektorin e ujërave dhe përpunimit të të dhënave në bazë të sasisë së ujit që ato kanë sot dhe volumit të depozitimeve që janë krijuar ndër vite, konstatohet se gjendja e këtyre veprave të mbedhjes së ujit është drejt degradimit. Situata e liqeneve aktualisht le shumë për të dëshiruar pasi dy prej tyre shfrytezohen minimalisht, kurse dy të tjerë janë tërësisht jashtë funksionit si pasojë e mungesës së investimeve e ndërhyrjeve mirëmbajtëse. Të katër liqenet së bashku kanë një kapacitet rreth 531.000 m³ ujë dhe nëse do të shfrytezoheshin plotësisht do të përmiresonin dukshëm situatën e vaditjes duke shtuar sipërfaqjen e tokës së vaditshme me 600 hektarë.



Tabela 6¹ : Të dhënat teknike lidhur kapacitetin e ujëmbledhësve dhe permasimi i tyre .

Emri i Liqenit	Viti i ndërtimit	Kapaciteti m ³	Sip. Vaditjes Ha	Gjatësia Digës në m	Lartësia Digës në m (Hashi)
Liqeni i Grazhdanit	1972	400000	80	200	22
Liqeni i Vojnikës (Çernenës)	1966	45000	15	60	15
Liqeni i Pesjakës (Maqellares)	1969	51000	17	80	10
Liqeni i Kurbegut (Fushës së Vogël)	1969	35000	10	70	8

5. Rekomandime

- Të bëhet studim lidhur me mundësinë e përdorimit të këtyre depozitimeve në sektorin e Bujqësisë.
- Të sigurohet mbrojtja e pellgjeve ujëmbledhëse për këto liqene nga depozitimet dhe aluvionet që mbarten gjatë periudhës së rreshjeve.
- Të studiohet mundësia e mbingritjes së digave, si mundësi më e mirë për të akumuluar sasi më të madhe uji.
- Të përmirësohet gjendja e sigurisë së digave, ujëlëshuesve dhe shkarkuesve katastrofikë, për të funksionuar në mënyrë të përhershme si mjetet e vetme të kontrollit mbi sigurinë e tyre.
- Të fuqizohet menaxhimi i sistemit të vaditjes në nivel lokal dhe në nivel fshati;
 - ❖ Të rritet përgjegjësia e kontrollit teknik për digat nga ana e strukturave bashkiake;
 - ❖ Të ndërtohet sistemi i monitorimit të digave;
 - ❖ Të ngrihet dhe funksionojë sistemi i menaxhimit financiar lidhur me përdorimin e liqeneve.
- Në këndvështrimin afatgjatë, rekomandohet që të nxitet bashkepunimi ndër-kufitar midis Komunës së Dibrës së Madhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkisë Dibër, për sigurimin e vaditjes së fushës së Dibrës dhe Maqellarës nga lumi i Radikës.

5.1 Rrjeti vaditës, problematikat dhe rekomandimet

Verifikimi në terren i situatës së kanaleve vaditëse vijon si më poshtë:

- Mungesa e mirëmbajtjes së tyre;
- Humbje të sasisë së ujit për shkak të terrenit dhe përbërjes granulometrike të dherave ku kalon uji;
- Keq-menaxhim i kanaleve vaditës dhe i kanaleve të furnizimit të ujëmbledhësve për shkak të devijimit në zona të caktuara nga banorët në fshatra dhe disa lagje përgjate kanalit.

¹ Kjo tabelë është përgatitur me të dhëna të marra pranë ish Drejtorisë Bujqësisë Dibër dhe nga matjet e kryera në terren.



Financuar nga LevizAlbania



Në projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

5.2 Rekomandimet për përmirësimin dhe vënien në funksion të rrjetit vaditës:

- Ngritja e një bordi në qeverisjen vendore për menaxhimin e rrjetit vaditës;
- Ndërtimi i **kanaleve vaditëse prej betoni ose me tubacione për të eliminuar humbjet apo filtrimet gjatë lëvizjes së ujit.**

Punoi : Elmaz Kadria

Firma:

Peshkopi: